

PUNA E ETF-SË MBI MOSPËRPUTHJEN E SHKATHTËSIVE NË VENDET PARTNERE: DISA ÇËSHTJE DHE GJETJE PARAPRAKE

NJË SHËNIM I SHKURTËR PËR FOLËSIT NË KËTË NGJARJE NDËRKOMBËTARE (25 NËNTOR 2021)

Përgatitur nga Mircea Badescu e ETF-së, me kontributin e Cristina Mereuta.

Tetor 2021

Hyrje

Mospërputhja e shkathtësive¹ reflekton në ndryshime në tregun e punës, disa me ritme të shpejta, dhe ndërlidhet me kapitalin njerëzor. Teprica e kapitalit njerëzor matet në mënyrë tipike në pikëpamje të mbi-shkollimit ose mbi-kualifikimit.² Megjithatë, teprica e arsimit mund të ndërlidhet edhe me mospërputhjen horizontale (ose fushën e studimit), ku punëtorët janë të punësuar në punë që nuk përkojnë me shkathtësitë dhe njohuritë që i kanë fituar gjatë shkollimit të tyre formal.

ETF-ja ka realizuar një nismë pilot që synon ta hetojë fizibilitetin për ta matur frekuencën e mospërputhjes së shkathtësive në disa vende partnere (gjatë vitit 2017/18)³. Bazuar në këtë element të punës dhe pas përpunimit të mëtejshëm të kornizës së matjes⁴, një ekip i ETF-së⁵ e ka formuluar dhe vlerësuar mospërputhjen vertikale dhe horizontale në shumicën e vendeve partnere të ETF-së⁶ gjatë vitit 2020/21. Disa gjetje paraprake janë paraqitur më poshtë dhe ato do të diskutohen më 25 nëntor 2021 në një ngjarje ndërkombëtare onlajn.

Ky shënim i shkurtër i paraqet disa çështje nga puna jonë dhe rezultatet e përkohshme për dy tregues që janë përdorur për ta matur frekuencën e mospërputhjes vertikale. Secili tregues i ka anët e tij të forta dhe të dobëta dhe kjo duhet të përcaktohet qartë në kontekstin e vendeve partnere të ETF-së (vendet fqinje të BE-së dhe Azia Qendrore). Si e tillë, ajo është thelbësore për të vlerësuar cilat të dhëna kërkohen për t'i llogaritur treguesit para se vendeve t'u jepen rekomandime, pasi asnjë metodologji nuk mund të jetë më e sigurt se të dhënat themelore.

Qasja e ETF-së për matjen e mospërputhjes së shkathtësive në vendet partnere

Ne e fokusuar punën tonë në disa pyetje të hulumtimit, si: Cilat janë llojet më të rëndomtë të mospërputhjes së shkathtësive në vendet partnere? Cilat janë grupet e të dhënave në dispozicion, deri në çfarë mase ato janë të qasshme, të besueshme ose të krahasueshme ndërkombëtarisht? A është i mundur përcaktimi dhe grumbullimi i një grupi të treguesve kryesorë të krahasueshëm mbi frekuencën e mospërputhjes së shkathtësive në vendet partnere? Cilat janë të metat kryesore në llogaritjen e këtyre treguesve? Cilat mund të jenë implikimet kryesore të politikave të mospërputhjes, duke e pasur parasysh kontekstin socio-ekonomik të secilit vend? Si mund të ndërmarrin ETF-ja dhe vendet partnere të saj hapa të mëtejshëm për ta siguruar një vlerësim të rregullt të frekuencës dhe dinamikës së mospërputhjes me kalimin e kohës?

¹ Veçanërisht, mospërputhja e shkathtësive mund të përdoret për ta përshkruar mospërputhjen vertikale (zakonisht të matur nga pikëpamja e mbi-shkollimit, nën-shkollimit, mbi-kualifikimit dhe nën-kualifikimit), mospërputhjen horizontale (zakonisht krahasohen fushat e studimit dhe të punës), boshllëqet e shkathtësive (shkalla deri në të cilën punëtorëve u mungojnë shkathtësitë e nevojshme për ta kryer punën e tyre aktuale), mungesën e shkathtësive (zakonisht të matur nga pikëpamja e vendeve të lira të paplotësuara dhe të vështira për t'u plotësuar) dhe vjetërsimin e shkathtësive (shkathtësitë mund të vjetërsohen për shkak të plakjes, përmes ndryshimeve teknologjike ose ekonomike, gjë që i bën disa shkathtësi të panevojshme, ose përmes mospërdorimit të shkathtësive).

² Literatura e politikave parapëlqen ta përdorë fjalën “mbi-kualifikim” në vend të “mbi-shkollim” me arsyetimin se është gjithmonë më mirë të kesh më shumë njerëz të shkolluar sesa më pak. Ekziston një mospajtim i ngjashëm për fjalën “mbi-kualifikim”, pasi besohet se të kesh më shumë shkathtësi është gjë e mirë në përgjithësi.

³ Serbia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Gjeorgjia, Egjipti dhe Maroku.

⁴ Korniza e mospërputhjes e ETF-së përbëhet nga dhjetë tregues: tre tregues që e matin mospërputhjen vertikale dhe horizontale, tre tregues kontekstualë dhe katër opsionalë. Në këtë shënim janë përfshirë vetëm dy tregues që e matin mospërputhjen vertikale.

⁵ Përfshirë ekspertët nga Economix (Gjermani), të udhëhequr nga Prof. Ben Kriechel.

⁶ Shqipëria, Armenia, Bjellorusia, Bosnja dhe Hercegovina, Egjipti, Gjeorgjia, Izraeli (të konfirmohet - puna në proces e sipër), Jordania, Kosova*, Kirgistani, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Palestina, Serbia, Tunizia, Turqia dhe Ukraina.

ETF-ja i ka zgjedhur vlerësimet e bazuara në Anketën e Fuqisë Punëtore, kryesisht për ta siguruar një shkallë të lartë të harmonizimit, krahasimit dhe vlefshmërisë së rezultateve. Kjo është e rëndësishme pasi vlerësimet e mospërputhjes nganjëherë janë sfiduese dhe mund të çojnë në pranim të kufizuar, posaçërisht ndër politikëbërësit. Për ne, të dhënat në dispozicion, krahasimi i tyre dhe përdorimi i klasifikimeve të standardizuara ndërkombëtare kanë qenë kriteret kryesore që janë ndjekur me rastin e sugjerimit / angazhimit në llogaritjen e metrikave të reja për studimin e mospërputhjes së shkathtësive. Gjithashtu, edhe lehtësia e interpretimit për treguesit e llogaritur ka qenë prioritet.

Çekuilibrat në tregun e punës: çfarë roli për mospërputhjen e shkathtësive? Gjetjet e para nga puna e ETF-së.

Të dhënat e përkohshme⁷ për nja njëzet vende partnere tregojnë se në vitin 2019, së paku një në katër të diplomuar në nivelin terciar mbanin punë që kërkonin nivele më të ulëta të kualifikimeve formale në pjesën më të madhe të vendeve, por frekuenca ishte e lartë, një në tre të diplomuar në Gjeorgji, Turqi ose Ukrainë, dhe arrinte pothuaj gjysmën e të diplomuarve në nivelin terciar në Tunizi. Të dhënat e përkohshme të ETF-së gjithashtu tregojnë se frekuenca e mospërputhjes për të diplomuarit e shkollës së mesme të lartë / pas shkollës së mesme (p.sh. niveli i mesëm i kualifikimit) është më e ulët se ajo e të diplomuarve në nivelin terciar. Sipas të dhënave në dispozicion, të rinjtë e diplomuar në nivelin terciar kishin frekuencë më të lartë të mbi-kualifikimit në të gjitha vendet: në vitin 2019, rreth dy të tretat kishin mospërputhje (d.m.th. kanë mbajtur punë që kërkojnë nivele më të ulëta të kualifikimeve formale në ISCED [Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit]) në Tunizi, rreth gjysma e tyre në Kirgistan, Serbi ose Turqi, rreth 40% në Shqipëri, Gjeorgji ose Kosovë dhe një e treta në Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Moldavi, Palestinë ose Ukrainë.

Disa vende, si Shqipëria, Kosova, Moldavia, Palestina ose Turqia, që shfaqin përqindje më të ulëta të punëtorëve me kualifikim të lartë në fuqinë punëtore (d.m.th., që kanë një nivel të arritjes në arsimin terciar në ISCED), kanë parë një rritje të madhe dhe të shpejtë të madhësisë së këtij grupi në vitet e kaluara. Megjithatë, kjo rritje nuk ka çuar gjithmonë në perspektiva më të mira për punësim, dhe në disa vende, të kesh diplomë universitare nuk do të thotë gjithmonë të jesh i punësuar dhe / ose të jesh i përshtatshëm për atë punë (ETF, 2020)⁸. Kjo tregon se sistemet arsimore përballen me shumë sfida për t'iu përgjigjur kërkesave, të cilat vazhdimisht ndryshojnë, për shkathtësi. Kjo gjithashtu mund të sugjerojë se shumë të diplomuar me kualifikime më të larta duhet të pranojnë vende të punës nën nivelin e tyre të kualifikimit formal (ISCED). Shkallët e larta të papunësisë dhe mundësitë e kufizuara në tregun e punës i detyrojnë posaçërisht individët me arsim të lartë që të pranojnë pozita të tilla.

Në vitin 2019, së paku një në katër punëtorë ishte i mbi-shkolluar⁹ në shumicën e vendeve me të dhënat në dispozicion¹⁰, kjo përqindje arriti në një të tretën e punëtorëve në Armeni, Tunizi ose Turqi. Frekuenca e mbi-shkollimit është zakonisht më e lartë në pjesën më të madhe të vendeve, duke arritur kulmin në rreth 40% të të rinjve në Tunizi ose Turqi dhe duke prekur vetëm një në dhjetë të rinj vetëm në tri vende: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Maqedoni të Veriut. Niveli relativisht i lartë i mbi-shkollimit të punëtorëve mund të sugjerojë se diplomimi nuk çon medoemos në një integrim që përputhet në tregun e punës dhe mund të sinjalizojë humbje të kapitalit njerëzor. Mund të ketë shumë arsye prapa kësaj situatë, dhe nevojiten më shumë analiza specifike për vendin për t'i identifikuar përcaktuesit dhe

⁷ ETF (e ardhshme), *Mospërputhja e shkathtësive: Matja dhe implikimet e politikave në vendet partnere të zgjedhura të ETF-së.*

⁸ ETF (2020), [Zhblokimi i potencialit të të rinjve në Evropën Juglindore dhe Turqi: Zhvillimi i shkathtësive për tregun e punës dhe përfshirjen sociale.](#)

⁹ Të mbi-shkolluar janë ata që zakonisht mbajnë vende të punës për të cilat vlera modale (d.m.th. ajo e identifikuar më së shpeshti) në një shpërndarje të punës / profesionit në vendin e tyre është zakonisht nën nivelin e tyre të shkollimit (ISCED).

¹⁰ Shqipëria, Armenia, Bjellorusia, Bosnja dhe Hercegovina, Egjipti, Gjeorgjia, Izraeli (të konfirmohet - puna në proces e sipër), Jordania, Kosova, Kirgistani, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Palestina, Serbia, Tunizia, Turqia dhe Ukraina.

zgjdhjet më efektive për t'i parandaluar ose për t'iu kundërvënë çekuilibrave të tillë. Ajo që shihet qartë është se sistemet arsimore vetëm pjesërisht gjenerojnë mospërputhje të tilla përmes politikave shkurtpamëse të regjistrimit, cilësisë së dobët dhe rëndësisë së programeve arsimore ose dështimeve në adresimin e qëllimeve të përfshirjes sociale. Udhëzimet për karrierë dhe edukimi për karrierë që nga shkollimi i hershëm e tutje, shërbimet efektive të përputhjes dhe programet për fitimin e përvojës së punës gjatë fazës së kalimit nga shkolla në punë janë gjithashtu thelbësore.¹¹

Disa vërejtje nga ne. Presim t'i dëgjojmë edhe vërejtjet tuaja.

Matja dhe kuptimi i madhësisë dhe ndërlidhjes së formave të ndryshme të mospërputhjes së shkathtësive gjithmonë kërkon një kombinim të treguesve dhe analiza të rezultateve nga metoda të ndryshme.

Kemi vërejtur se çdo përqendrim ekskluziv në këtë ose atë tregues mbi frekuencën e mospërputhjes mund të shpjerë nganjëherë në interpretim të gabuar ose jo të plotë të gjetjeve.

Kemi konstatuar veçanërisht se çdo gjetje mbi frekuencën / përcaktuesit e mospërputhjes duhet të jetë gjithmonë e kontekstualizuar mirë duke i marrë parasysh kushtet themelore specifike për vendet në tranzicion dhe vendet në zhvillim. Korniza e matjes së ETF-së përfshin edhe disa tregues kontekstualë të cilët i diskutojmë gjithmonë me vendet (p.sh. punësimi / papunësia / pasiviteti, të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk e ndjekin shkollën apo nuk janë në trajnim - NEET). Kjo lejon një formulim më të mirë të mospërputhjes.

Së fundi, besojmë që rekomandimet e politikave për mospërputhjen e shkathtësive duhet të përpiqen gjithmonë për rëndësinë, duke e përmendur llojin specifik të mospërputhjes në fjalë dhe si pritet që politikata ta trajtojnë atë.

¹¹ (ETF, 2021), M. Badescu dhe C. Mereuta, *Mospërputhja e shkathtësive: Matja dhe implikimet e politikave në vende të zgjedhura, në [Ndryshimi i shkathtësive për një botë në ndryshim e sipër: Kuptimi i kërkesës për shkathtësi në vendet fqinje të BE-së.](#)*